



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA POGRADEC
KESHILLI

Nr. 2550/prot.

Pogradec, më 29. 06 2023

VENDIM

Nr. 64, DATË 27 / 06 /2023

PËR

NJË NDRYSHIM NË VENDIMIN E KËSHILLIT BASHKIAK NR 84 DATË 19.10.2021 PËR FILLIMIN E PROCEDURAVE PËR TRANSFERIMIN NË PRONËSI TË BASHKISË POGRADEC, TË PASURISË NR 9/1, ZK 8581, ME SIPERFAQE 281,2 M2 TRUALL DHE 562.4 M2 NDERTESE, NGA MINISTERIA E INFRASTRUKTURËS DHE ENERGJISË, SHËRBIMI GJEOLOGJIK SHQIPTAR, PRONAR I KËSAJ PASURIE”.

Në mbështetje të nenit 8, shkronjës “a” dhe shkronjës “a” të pikës 1.2 të nenit 9, të ligjit Nr.139/2015 “Për vetëqeverisjen vendore”, të ndryshuar, Ligjit Nr.8743, datë 22.2.2001, “Për pronat e paluajtshme të shtetit”, i ndryshuar, Ligjit Nr. 8744, datë 22.2.2001 “Për transferimin e pronave të paluajtshme publike të shtetit në njësitë e qeverisjes vendore”, i ndryshuar, Vendimit të Këshillit të Ministrave me Nr. 500, datë 14.08.2001 "Për inventarizimin e pronave të paluajtshme shtetërore dhe transferimin e pronave organeve të qeverisjes vendore”, shkresës nr 1003/1 prot datë 15/09/2021 të Shërbimit Gjeologjik Shqiptar në përgjigje të shkresës së Bashkisë së Pogradecit Nr. 4198 prot , datë 09.04.2022, drejtuar Ministrisë Infrastrukturore, dhe Shërbimit Gjeologjik Shqiptar, dhe shkresës nr 14595/1 prot date 12/09/2022 të Angjesisë Shtetërore të Kadastrës, dhe kopjet e kartelave të këtyre pasurive, me propozim të Kryetarit të Bashkisë, Këshilli i Bashkisë:

VENDOSI:

1. Të miratojë ndryshimin e pikës nr 1 të Vendimit nr 84 date 19.10.2021 të Këshillit të Bashkisë Pogradec si me poshtë:
 - Të miratojë fillimin e procedurave të transferimit në pronësi të Bashkisë Pogradec të pasurisë me nr 9/1+1-5 ndodhur në Zonën Kadastrale 8581 me sipërfaqe, 190 m2 me adresë rruga industriale lagjia nr 1 Pogradec, dhe të pasurisë me nr 9/1+1-4 ndodhur në Zonën Kadastrale 8581 me sipërfaqe, 190 m2 me adresë Rruga Industriale lagjia nr 1 Pogradec, nga Shërbimi Gjeologjik Shqiptar pronar i kësaj pasurie.
2. Për zbatimin e vendimit ngarkohet Kryetari i Bashkisë, Drejtoria e Burimeve Njerezore dhe Çështjeve Juridike, si dhe Drejtoria e Planifikimit, Kontrollit dhe Zhvillimit të Teritorit.
3. Ky vendim hyn në fuqi 10 ditë nga data e shpalljes.

KRYETARE E KËSHILLIT

Manjola KAMOLLI

